



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë
Nr. Dok. 201502601/4

Tiranë ___/___/2016

Lënda : Rekomandohet *"Përmirësimi i veprimtarisë së punës të organit të Prokurorisë, mbi konstatime dhe problematika, pas trajtimit të ankesave të qytetarëve për vitin 2015"*.

Drejtuar : Prokurorit të Përgjithshëm
Z.Adriatik LLALLA

TIRANË

I nderuar Z.Prokuror i Përgjithshëm,

Qysh në fillim do të shprehnim vlerësimin tonë, për bashkëpunimin e mirë me institucionin që Ju drejtoni, si sa i përket respektimit të afateve në kthimin e përgjigjeve të shkresave tona, ashtu dhe vlerësimin të rekomandimeve për fillimin e hetimeve për vepra penale të ndryshme.

Institucioni i Avokatit të Popullit si një institucion i pavarur kushtetues, i cili ka për mision mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve ndaj veprimeve ose mosveprimeve të organeve të administratës publike, në veprimtarinë e punës së tij, trajton edhe ankesa në të cilat ata ngrenë pretendime të ndryshme ndaj organit të Prokurorisë.

Gjatë vitit 2015 në Institucionin e Avokatit të Popullit kanë ardhur dhe janë trajtuar 90 ankesa të qytetarëve. Nga studimi dhe analiza e tyre konstatohet se ankesat paraqiten në mënyrë të grupuar si më poshtë:

Së pari: Për zvarritje të pajustificuara në hetimin e procedimeve penale. Të tilla kanë qënë 8 ankesa, ku për 1 rast është ndaj Prokurorisë për Krime të Rënda e cila ka zvarritur për 1 vit, hetimet e procedimit penal në ngarkim të pandehurit C.A.P.T., shtetas i huaj, i akuzuar për veprën penale "Trafikimi i narkotikëve", parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodfit Penal.

Gjatë trajtimit të këtyre ankesave është konstatuar se zvarritjet në hetim janë rrjedhojë e moskryerjes së hetimeve të gjithanshme, veprimeve hetimore pa plan dhe jo në vijimësi. Më e theksuar kjo, në ato raste kur pas ankesës së kallëzuesve ndaj vendimeve të marra nga Prokuroria për mosfillimin e procedimit penal apo pushimit të çështjes gjykata i ka shfuqizuar ato duke lënë dhe detyra konkrete. Pas dërgimit të akteve të çështjes penale nga gjykata, organi procedues nuk ka kryer menjëherë veprimet hetimore, e në raste të veçanta dhe detyrat e lëna nga gjykata.

Si shkaqe për zvarritjen e hetimeve vazhdojnë të mbeten kryerja e ekspertimeve të ndryshme, shpesh dhe disa ekspertimeve në një procedim të vetëm; kryerja dhe administrimi me vonesë i akteve të ekspertimit; mosvlerësimi, mosshqyrtimi apo shqyrtimi me vonesë i kërkesave të palëve në procesin penal sidomos pretendimeve të personit nën hetim; mosparaqitja e dëshmitarëve në fazën e hetimit paraprak rrjedhojë dhe e adresave të pasakta të tyre; kthimi me vonesa i përgjigjeve të letërporosive të autoriteteve të drejtësisë të shteteve të huaja etj.

Zvarritjen e hetimit të procedimeve penale Avokati i Popullit e ka ndjekur me shqetësim duke e vlerësuar në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor, në respekt të detyrimeve të parashikuara në pikën 2 të nenit 42 të Kushtetutës së R.SH., dhe nenit 6 të KEDNJ.

Për rrjedhojë sugjerohet që organi i Prokurorisë të marrë masat e nevojshme me qëllim shmangjen e vonesave gjatë hetimeve paraprake dhe në raste të veçanta për sa është e mundur edhe gjatë gjykimit të çështjeve penale. Shpejtësia në hetim do të minimizojë mbipopullimin e IEVP-ve, si dhe kostot financiare që pasojnë këtë situatë.

Së dyti: Në mosrespektimin e të drejtës së informimit për veprimet e kryera gjatë fazës së hetimit, apo vendimet përfundimtare për mënyrën e zgjidhjes së kallëzimeve penale ose përfundimit të hetimit.

Kështu, në 10 raste qytetarët janë ankuar ndaj Prokurorisë për mosnjohimin lidhur me mënyrën e zgjidhjes së kallëzimeve penale, pasi kishte kaluar afati 30 ditor i verifikimit të tyre. Po ashtu në 8 raste, qytetarët kanë pretenduar se nuk kanë marrë dijeni menjëherë për vendimin e mosfillimit të procedimit penal apo pushimit të çështjes.

Për rastet e pezullimit të hetimit, Prokuroria në pjesën më të madhe të tyre nuk njofton apo nuk iu dërgon palëve vendimin përkatës, me arsyetimin se “Ky detyrim nuk parashikohet në nenin 326 të Kodit të Procedurës Penale”. Avokati i Popullit ka insistuar në respektimin e të drejtës së qytetarit për t’u informuar me vendimet përfundimtare të marra nga Prokuroria dhe veç kësaj i ka dërguar Ministrit të Drejtësisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Kuvendit, rekomandimin legjislativ për shtesë në dispozitën përkatëse të K.Pr.Penale, për ankimin që duhet të bëjnë qytetarët ndaj vendimit të pezullimit të hetimit, parashikuar nga neni 326 i K.Pr.Penale.

Së treti: Në mosvënien në dispozicion të akteve të ndryshme nga fashikulli i hetimit, apo dokumenteve të sekuestruara .

Qytetarët në 5 raste, në ankesat e tyre kanë ngritur shqetësimin për mosdhënie të akteve të ndryshme, apo dokumenteve që ata kanë disponuar mbi pasuri si automjete etj, të sekuestruara nga Prokuroria; të fotokopjeve të vendimeve të mosfillimit të procedimit penal apo pushimit të çështjes penale. Nga mosveprimi

i organit procedues, dhe zvarritjet për mosdhënie të akteve të ndryshme të procedimit penal kanë ardhur pasoja në cënim të interesave të ligjshme të qytetarëve si, moskryerje e veprimeve me automjetet në pronësi e pengesa në aktivitetin e biznesit privat apo familjar dhe zvarritje të procedurave për ankimimin në gjykatë etj.

Në vëmëndjen tuaj do të përmëndnim dhe trajtimin e sendeve prova materiale të sekuestruara gjatë hetimit nga Prokuroria. Edhe pse rregulli bazë për kthimin e sendit të vjedhur të sekuestruar është atribut i gjykatës, neni 218 i Kodit Penal i jep diskrecionin prokurorit që të realizojë kthimin pronarit të ligjshëm edhe në fazën e hetimeve paraprake. Pra, pasi të jenë kryer veprimet e nevojshme procedurale me sendin (mjetin), kur nuk dëmtohet hetimi i çështjes, prokurori pa hezitim dhe pa vonesa duhet të kthejë mjetin, pasi e kundërta do të sillte pasoja në biznesin familjar apo aktivitete të tjera të qytetarit.

Në këtë material duam të paraqesim dhe disa problematika, e konkretisht:

1. Nëpërmjet rekomandimeve me të cilat u jemi drejtuar, jeni në dijeni të faktit se Avokatit i Popullit ka filluar 9 raste me inisiativë sidomos kur ato janë bëra publike në media, për ushtrimin e dhunës fizike ndaj qytetarëve prej punonjësve të Policisë së Shtetit në mjediset e Policisë apo jashtë tyre. Në 2 raste të tjera rekomandimet kanë qënë për dhunën e ushtruar nga punonjësit e Policisë së Burgjeve ndaj të dënuarve apo të paraburgosurve në mjediset e IEVP-ve.

Për këto raste është kryer një hetim i gjithanshëm, i cili ka konsistuar jo vetëm në marrjen e deklarimeve të personave të dëmtuar nga vepra penale; personave të dyshuar si autorë të kryerjes së tyre (ku megjithë ftesat për paraqitje, shpesh ata nuk paraqiten në Institucionin e Avokatit të Popullit për të dhënë deklarime), por dhe në prova të tjera si, kërkesa për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor pranë IML-së Tiranë dhe administrimit të shpejtë të aktit mjeko ligjor; fotove të personave të dëmtuar dhe marrjes së fotokopjeve të dokumenteve të ndryshme nga Policia e Shtetit si, raporte shërbimi, proces verbale, fletë të rregjistrit për personat e ndaluar/arrestuar etj.

Në përfundim, kemi gjykuar se materiali ka qënë i plotë si përsa i përket provave ashtu dhe kualifikimit të veprës penale. Për këtë i jemi drejtuar Prokurorive në Rrethet Gjyqësore duke vënë në dijeni dhe Prokurorin e Përgjithshëm “Për fillimin e hetimeve për veprën penale “Kryerja e veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal.

Vetëm në një rast dhe konkretisht për ankesën e shtetasit M.GJ., nga Shkodra, i kemi rekomanduar Prokurorisë së atij rrethi fillimin e hetimeve për veprën penale “Tortura”, parashikuar nga neni 86 i Kodit Penal. Organi i Prokurorisë ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, i cili pasi është studjuar na është dukur i padrejtë dhe i pabazuar në ligj e prova. Për këto arsye kemi kërkuar pranë Zyrës Tuaj, shfuqizimin e këtij vendimi.

Vlen të theksohet fakti i zgjerimit të hetimit dhe qëndrimit të mbajtur nga Avokati i Popullit, në lidhje me përgjegjësinë edhe të personave të tjerë të pranishëm gjatë ushtrimit të dhunës nga drejtues të policisë. Mbi këtë bazë është rekomanduar fillimi i hetimit edhe për veprën penale “Mosmarrja e masave për të ndërprerë gjëndjen e paligjshme”, parashikuar nga neni 291 e Kodit Penal, ndaj personave përgjegjës.

Vërehet se organi i Prokurorisë pas marrjes në shqyrtim të Rekomandimeve i ka vlerësuar ato dhe ka filluar hetimet e procedimeve penale duke vënë në

dijeni Instituconin e Avokatit të Popullit. Është për t'u përmëndur rasti i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë, ku pas rekomandimit për fillim hetimi për veprën penale të parashikuar nga neni 250 të Kodit Penal ndaj n/drejtorit të Policisë shtetasit A.H, dhe punonjësve të tjerë të policisë ka dërguar çështjen në gjyq. Ndërsa, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë ka pushuar hetimin e procedimit penal ndaj punonjësve të policisë së IEVP "Zahari" Krujë për keqtrajtim ndaj të dënuarit R.H., dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës për rastin e keqtrajtimit të të dënuarit A.L., person që vuan nga sëmundja e epilepsisë.

I përmëndëm këto raste, për të theksuar domosdoshmërinë e rritjes së rolit aktiv të Prokurorisë në respektim të të drejtave të njeriut, kur ato cënohen nga funksionarë publikë dhe sidomos punonjës të Policisë së Shtetit, të cilët gjatë vitit 2015, kanë qënë drejtues të lartë duke filluar nga nëndrejtor policie, shefa komisaratesh dhe deri në punonjës të rolit bazë.

Nga hetimet e kryera prej ekspertëve të Avokatit të Popullit, për këto raste konstatohen dhe disa mangësi si:

- a) Jo gjithmonë ka vlerësim të rasteve kur konstatohen shënja të dukshme dhune tek qytetarët, për të cilat organi i Prokurorisë duhet të kryejë verifikimet e nevojshme dhe të iniciojë fillimin e procedimit penal.
- b) Kryerja e veprimeve hetimore procedurale nga Policia Gjyqësore e Policisë së Shtetit bëhet e njëanshme dhe dëmton objektivitetin e hetimit. Për këtë do të sugjerohet që me vënien dijani të Prokurorit të gatshëm për ngjarjen, hetimet duhet të ndiqen nga Policia Gjyqësore e Prokurorisë.
- c) Jo në pak raste qytetarët janë "arrestuar në flagrancë" për vepra të tilla penale si, "Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik", "Mosbindja ndaj urdhërit të punonjësit të Policisë së rendit publik " etj, rrjedhojë në disa raste dhe e sjelljeve jo etike e profesionale të punonjësve të Policisë së Shtetit, shpesh në kapërcim të kompetencave ligjore në përdorimin e forcës ndaj qytetarëve. Në praktikë nga punonjësit e Policisë së Shtetit përpilohet raporti i shërbimit, i cili vlerësohet si korrekt dhe i mirëqënë. Mendojmë se në këto raste organi i Prokurorisë duhet të tregohet më rigoroz dhe kërkues në hetim, për të sqaruar pozitën procedurale si të autorit të dyshuar për kryerjen e këtyre veprave penale, ashtu dhe ndaj punonjësve të policisë që kanë ushtruar dhunë, me qëllim për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e tyre të ligjshme.

2. Në institucionin e Avokatit të Popullit qytetarë të ndryshëm familjarë të personave me probleme të shëndetit mendor, kanë paraqitur pretendime ndaj organit të Prokurorisë për mosnxjerrjen e urdhërit të ekzekutimit të vendimit të gjykatës, të cilat përmbajnë masa mjekësore të detyrueshme, parashikuar nga nenet 46 dhe 239 të Kodit të Procedurës Penale.

Në praktikën e punës konstatohet se personat e papërgjegjshëm të cilët kanë kryer vepra penale dhe që gjykata ka vendosur masë mjekësore "Mjekim të detyruar" në një institucion mjekësor psikiatrik, pra të specializuar, janë dërguar për ruajtje dhe trajtim mjekësor në spitalet e burgjeve. Ky veprim është në kundërshtim me nenin 28 të ligjit nr.44/2012 "Për shëndetin mendor". Mbajtja e këtyre personave në spitale apo seksione brënda sistemit të burgjeve, përbën

një trajtim degradues dhe jo njerëzor, pasi bie ndesh me Deklaratën Universale të Drejtave të Njeriut dhe nenin 3 të KEDNJ. Në këto akte ndërkombëtare personat me çrregullime të shëndetit mendor trajtohen si të paafte dhe cënueshëm, prandaj atyre duhet t'u sigurohet trajtim i duhur mjekësor, përshtatshëm e ndihmës dhe e përkujdesit mjekësor në një Institucion Psikiatrik të Specializuar.

Në rekomandimet e Avokatit të Popullit është theksuar me forcë trajtimi i këtyre personave me çrregullime të shëndetit mendor në institucione mjekësore të posaçme psikiatrike, jashtë sistemit të burgjeve. Ky shqetësim bëhet dhe më evident për faktin se numeri i personave me masë mjekësore "Mjekim i detyruar në një institucion psikiatrik" është deri në 150, nga të cilat rreth 20 përqind janë në Qendrën Spitalore të Burgjeve dhe pjesa tjetër në seksionet e I EVP-ve "Zahari" Krujë dhe Durrës, në kushte jo të mira e dinijtoze. Pra, si shifet konstatohet mungesa e institucioneve të specializuara mjekësore për këto kategori personash, për të cilët është pretenduar ngritja e një Spitali Psikiatriko-Ligjor në Durrës, i cili do të përfundojë gjatë vitit 2017.

Në këtë situatë, kërkohet një bashkëpunim ndërinstitucional i Prokurorisë së Përgjithshme, Ministrisë së Shëndetësisë, Drejtorisë të Përgjithshme të Burgjeve, Avokatit të Popullit dhe Shoqërisë Civile, me qëllim gjetjen e një zgjidhje sa më të shpejtë të këtij problemi.

Në përfundim, do të kërkonim rritjen e performancës së punës së Prokurorëve dhe sjelljen e tyre etike dhe profesionale në marrëdhëniet me qytetarët, palë në procesin penal.

Duke besuar në mirëkuptimin Tuaj,

Me respekt

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI

Konc.&Dakt.P.A.
Kom.A.SH
Tiranë më 21.01.2016